

BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE

VOLUMI 8

(Korrik– Dhjetor 2020)

Përmbajtja

1. Vendim nr.797, datë 24.09.2020	4
2. Vendim nr.877, datë 14.10.2020	6
3. Vendimi nr.643, datë 22.06.2020	8
4. Vendim nr. 376, datë 10.06.2020	11
5. Vendim nr.00-2020-74, datë 08.06.2020.....	14
6. Vendim nr.620, datë 22.06.2020	18
7. Vendim nr. 704, datë 02.07.2020	21
8. Vendim nr.761, datë 27.07.2020	24
9. Vendim nr. 951, datë 18.11.2020	26

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankipimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në faqen legjislacionin, në linkun: <https://ëëë.tatime.gov.al/c//legjislacioni>

Shënim!

Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

1. Vendim nr.797, datë 24.09.2020

Gjykata Administrative Apelit Tirane

Paditës: Shoqëria “A”

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti:

1. Shfuqizim i njoftim vlerësimit nr. _____ prot, datë ____i Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj
2. Shfuqizim i Vendimit nr.____, datë ____ i Drejtorisë së Apelimit Tatimor

Shuma e detyrimit tatimor: 15,211,330 lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
2. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
3. Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin mbi te Ardhurat“;

Përmbledhje e fakteve:

Nga kontrolli i shitjeve të realizuara nga shoqëria u konstatua se, për periudhën tatimore 11/2015 - 12/2015 shoqëria “A” sh.p.k ka deklaruar shitje të përjashtuara në vlerën 10,260,972 lekë që përbëhen nga dhënia me qira e shesheve, duke i kategorizuar si shitje të përjashtuara bazuar në nenin 53 germa (h) të ligjit 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Shoqëria disponon faturën dhe kontratën për shërbimin e kryer, në të cilën e ka paraqitur shërbimin si qira shesh përdorimi.

Nga verifikimi i kontratave të qerasë si dhe i faturave tatimore të shitjes konstatohet se shoqëria “A” ka trajtuar si furnizim të përjashtuar nga TVSH-ja shërbimin e dhënies në përdorim të sheshit te depozitimit dhe të përpunimit në kalatën lindore.

Sipas objektit të kontratës veprimtaria ekonomike e parashikuar në të është aktivitet tatueshëm bazuar në Nenin 59 të Ligjit 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe ne nenin 50, pika B e Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Faturimet e bëra nga Autoriteti Portual__, në lidhje me qeranë e shesheve të magazinimit dhe të përpunimit megjithëse janë trajtuar si furnizime të

përfshirë nga ana e APD, kjo nuk i jep të drejtë shoqërisë “A” për të denaturuar furnizimin e tatueshëm në furnizim të përfshirë.

Autoriteti Portual i faturon “A” një tarifë si qira sheshi, ndërkohë që shoqëria “A” sheshin e vë në dispozicion të operatorëve sipas një tarifë të përcaktuar në funksion të përdorimit dhe kryerjes të veprimtarisë që i është përcaktuar në kontratën e koncesionit.

Në kontratën e koncesionit si objekt i veprimtarisë së shoqërisë “A” në asnjë rast nuk përcaktohet apo i lejohet “A” të japë me nënqera sheshin ose ndonjë objekt të tij, por të përdorë atë në funksion të veprimtarisë të përcaktuar nga kontrata e koncesionarit dhe për realizimin e shërbimeve të përcaktuara në këtë kontratë.

Çdo tarifë e trajtuar nga shoqëria “A” si dhënie me qira sheshi është shërbimi i vënies në dispozicion të sheshit ose ambjentëve të tij në funksion të kryerjes së veprimtarisë dhe shërbimeve të tjera nga “A” sipas kontratës së koncesionit. Pra, përshkrimi i shërbimit si qira sheshi nga “A” duke e trajtuar si të përfshirë, nuk është në përputhje me llojin e shërbimeve që duhet të kryejë “A” sipas kontratës së koncesionit.

Për sa më sipër, shërbimi i vënies në dispozicion të sheshit ose pjeseve apo ambjentëve të tij nuk është furnizim i përfshirë nga Tvsh-ja sipas nenit 53 të Ligjit 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” siç e ka trajtuar shoqëria duke denaturuar përshkrimin e llojit të shërbimit si qiradhënie, shërbim i cili nuk është në përputhje me objektin e kontratës së koncesionit dhe llojet e shërbimeve që duhet të kryejë kjo shoqëri.

Bazuar në nenet 2, 10 dhe 47 të Ligjit 92/2014 Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” persa shërbimi i kryer nuk duhet të trajtohet si furnizim shërbimi qiradhënie e pasurisë së paluajtshme të përfshirë nga Tvsh-ja, atëherë për këto shërbime do të llogaritet Tvsh 20% dhe sipas nenit 128 të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, shoqëria i llogaritet detyrimet dhe gjobat.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata arsyetoi se në bazë të ligjit nr. 9130 datë 8.9.2003 Autoriteti Portual në funksion të administrimit të pronës publike mund të japë me qira sheshin e portit për magazinim. Sipas kontratës koncesionare, i jepet koncesionarit e drejta për menaxhim, që sipas termave të kontratës përfshijnë shërbimet e përpunimit të ngarkesave, depozitimit dhe magazinimit, që do të thotë se shërbimet e trajtuara nga shoqëria si dhënie me qira e shesheve janë pjesë e menaxhimit të Terminalit Lindor të Portit të Durrësit. Shoqëria “A” ka lëshuar faturën tatimore për shërbimin e ofruar në port sikurse është përcaktuar në kontratën koncesionare duke lidhur kontrata qiraje me operatore të ndryshëm për sheshet e magazinimit të mallrave që do eksportohen, duke iu përmbajtur dispozitave ligjore në fuqi.

Vendim:

Shfuqizim akti administrativ objekt padie.

2. Vendim nr.877, datë 14.10.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Padites: Shoqëria “K”sha

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhënj

Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore

Objekti:

1. Shfuqizim pjesërisht i njoftim vlerësimit tatimor nr. ____, datë ____ të Drejtorisë Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhënj për detyrimin e TVSH- së së vitit 2017-2018 në shumën 422.793.068 lekë.
2. Shfuqizim i vendimit nr. ____, datë ____ të Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore.
3. Detyrimin e palëve të paditura t’i konsiderojë të rregullta faturat tatimore të shitjes të lëshuara kundrejt shoqërisë “K”.

Shuma e detyrimit tatimor: 441,484,887 Lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
2. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
3. Ligji nr.7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vleren e Shtuar“;

Permbledhje e Fakteve:

1) Nga verifikimi i blerjeve skrap brenda vendit për vitin 2017 dhe vitin 2018 rezulton se shoqëria ka kryer blerje skrap nga furnitorë që gjatë aktivitetit të tyre kanë krijuar gjendje skrap nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve apo mbetje teknologjike nga linjat e tyre të prodhimit (burime skrap këto që shoqërojnë edhe faturën e shitjes) dhe blerje skrap nga furnitorë që në veprimtarinë e tyre janë edhe grumbullues të skrapit.

Për blerjet e skrapit nga grumbulluesit, rezulton se pavarësisht kufizimit ligjor të nenit 76 pika 5 të ligjit 92/2014 "Për Tvsh-në në RSH", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 6, datë 30.01.2015 "Për tvsh-në RSH", i ndryshuar, neni 54, pika 5.a Neni 76 , për këto blerje është kredituar tvsh-ja e paraqitur në faturat e shitjes.

Nga shoqëria “K”sha dhe nga shoqëritë grumbulluese të skrapit, nuk është zbatuar skema e mbetjeve industriale, sipas Udhëzimit të TVSH- së, për rastet kur grumbulluesit e kryejnë grumbullimin e skrapit nga persona të tatueshem. Grumbulluesit, në zbatim të skemës, duhet të lëshonin fatura pa tvsh dhe shoqëria “K”sha duhet të lëshonte autongarkesa për çdo furnizim të kryer, bazuar në kërkesat

e nenit 100, pika 2 të ligjit 92/2014 "Për Tvsh-në në RSH", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 6, datë 30.01.2015 "Për tvsh-në RSH", i ndryshuar, neni 69, II, pika 2.a.

Gjithashtu, skema e përdorur është në kundërshtim edhe me shkresën udhëzuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. ____ Prot., datë ____, në përgjigje të kërkesës së shoqërisë "K" sha me nr. ____ Prot, datë ____ mbi skemën për mbetjet industriale për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar .

Në zbatim të nenit 68.5.b të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kryhet vlerësim tatimor. Shoqërisë i ulet teprica kreditore e TVSH për vitin 2017 në shumën 398.734.276 lekë dhe për periudhën 2018/01 i ulet teprica kreditore e TVSH në shumën 24.058.792 lekë.

2) Gjatë kontrollit është konstatuar se hekuri i blerë është shitur me një çmim mesatar më të ulët se ai i blerjes. Në zbatim të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 68.5.b, shitjet e tatueshme rivlerësohen në bazë të vlerave të krahasueshme, me të dhënat e shitjeve të shoqërisë për periudhën në të cilën ka ndodhur transaksioni, duke marrë për bazë çmimin më të lartë të shitjes 58,88 lekë/kg për periudhën kur artikulli hekur i blerë është shitur nën kosto. Diferenca në vlerë e krijuar nga shitja nën koston e blerjes së sasisë së hekurit të shitur, llogaritet në shumën 9.597.532 lekë (0.7 lekë/kg * 13,710,760 kg) me një detyrim për TVSH në vlerën 1.919.506 lekë.

Në zbatim të kërkesave të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 128.1, shoqëria përveç detyrimit për tvsh-në, penalizohet edhe me 50 % të detyrimeve të lindura për tvsh-në në shumën 959.753 lekë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Sipas Gjykatës aplikimi i nenit 100 të Ligjit 92/2014 është një mundësi e ofruar nga ligjvënësi për palët në transakson, mundësi që realizohet brenda kufijve të Udhëzimit të MFE në zbatim të nenit 100 të ligjit që mundëson zbatimin e kësaj skeme vëtëm për blerjet nga individët. Çdo furnizim i mbetjeve industriale i realizuar mes personave të tatueshem të regjistruar për TVSH inënshtrohet regullave të përgjithshme të faturimit të mallrave, dhe rrjedhimisht faturat duhet të plotësohen nga shitësi siç është zbatuar në rastin në gjykim. Shoqëritë që i kanë shitur skrap paditësit në të gjitha rastet kur kanë bërë grumbullim skrapit nga individë persona të paregjistruar e kanë zbatuar me përpikmëri skemën sipas shembullit të dhënë në udhëzim për të gjithë sasinë e grumbulluar prej tyre. Në lidhje me rivlerësimin e çmimit të hekurit nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj nuk rezulton të jete ndjekur procedura për të siguruar vlera të krahasueshme të këtij malli sipas percaktimeve të pikës 2 të nenit 36 të ligjit. Rivlerësimi është bërë bazuar në përlllogaritje të bera nga Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj në lidhje me hekurin e importuar dhe hekurin e blerë brenda vendit dhe jo si rrjedhojë e ndonjë konstatimi se çmimi i tregut për hekurin të jetë, i ndryshëm nga çmimi i faturuar për këtë mall nga ana e shoqërisë. Për pasojë procedura e ndjekur në lidhje me rivlerësimin e çmimit të shitjes së hekurit është e pabazuar në ligj.

Vendim: Shfuqizim akti administrativ objekt padie

3. Vendimi nr.643, datë 22.06.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “R” sh.p.k,

I paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

Objekti:

1. Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore me nr. _____ prot, datë _____ të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër.
2. Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ vendimit nr. _____ prot, datë _____ të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë, konkretisht të pikave 1, 2 dhe 3 të këtij akti.
3. Shpenzimet gjyqësore e proceduriale si dhe ato avokatore në ngarkim të palës së paditur

Shuma e detyrimit: 720 000 lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përmbledhje e Fakteve:

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin me detyrime vlerësuar sipas njoftim-vlerësimit nr. _____ prot, datë _____, dënim për punonjës të padeklaruar në vlerën 500.000 lekë, dënim për “mosafishim posteri për tërheqjen e kuponit tatimor” në vlerën 20 000 lekë, dënim për “moslëshim të kuponit tatimor” gjatë ofrimit të shërbimit në vlerën 3 400 000 lekë.

Subjekti duke mos qenë dakort me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë me një kërkesë ankimore në lidhje me të.

Drejtoria e Apelit Tatimor ka vendosur:

Ndryshimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr. _____ prot datë _____, nxjerrë nga D.R.T-ve Shkodër, përsa i përket gjobë për moslëshim kuponi tatimor në shumën 3.200.000 lekë.

Grupi i punës së Kontrollit Tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në ka ushtruar kontroll në ambjentet e ushtrimit të aktivitetit të subjektit Shoqëria “R” sh.p.k dhe ka mabjtur akt konstatim duke nxjerrë se në momentin e kontrollit dhe janë mbajtur procesverbale gjobe me numër serie _____, datë _____, sipas të cilit subjekti është sanksionuar me gjobë për “Moslëshim të kuponit tatimor” gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në ofrimin e shërbimit, bazuar në nenin 122, pika 1, gërma (b; i) të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për proçedurat tatimore në RSH-së” i ndryshuar.

Proçesverbali i gjobës me numër serie _____, datë _____, sipas të cilit subjekti është sanksionuar me gjobë

në vlerën 20 000 lekë për “Mosafishim posterit për tëheqjen e kuponit tatimor” gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, bazuar në nenin 122, pika 1, gërma (d) të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH-së” i ndryshuar.

Procesverbali i gjobës me numër serie _____ datë _____, sipas të cilit subjekti është sanksionuar dhe me një gjobë në vlerën 500 000 lekë për “punonjës të padeklaruar” para organit tatimor. Nga grupi i kontrollit tatimor është bërë verifikimi i të gjithë punonjësve të deklaruar si “*të punësuar*” nga subjekti para organit tatimor deri në atë kohë. Në bazë të praktikës hetimore administrative të ndjekur është vlerësuar, se ndër punonjësit e gjendur në punë ditën e konstatimit nuk është deklaruar në organin tatimor konform rregullave dhe afateve të përcaktuara ligjore punonjësi _____, konstatuar me detyrë si ndihmëskuzhinier.

Arsyetimi ligjor i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit çmon, se vendimi nr. ____ datë ____ i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit për pasojë ai duhet të lihet në fuqi nga kjo gjykatë.

Kolegji vlerëson, se gjykata administrative e shkallës së parë ka bërë vlerësim të drejtë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me çështjen objekt gjykimi.

Në kuptim të nenit 70 të ligjit nr.9920/2008 është evident fakti, se inspektorët e DRT-se Shkodër kanë pasur kompetencën për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor objekt kundërshtimi në këtë gjykim dhe ky njoftim është kryer pas verifikimit të faktit me akt- konstatimin Nr.____ datë ____ nga përmbajtja e të cilit rezulton, se shtetasi _____ ishte gjetur në punë në ambientet e palës paditëse si ndihmes kuzhinier dhe nuk ishte deklaruar si punonjës të paktën një ditë kalendarike më parë që është data _____.

Referuar nenit 80 të ligjit nr. 9920/2008, pikës 80.3. c dhe 119 të Udhëzimit Nr.24 datë 2.9.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, inspektorët e DRT kanë kryer kontrolle pranë paditësit në lidhje me zbatimin e legjislacionit tatimor, nëpërmjet procedurës së “verifikimit në vend” kontrolli, i cili kryhet pa njoftimin paraprak të personave të tatueshem, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e ditës të lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend, kërkesa të cilat referuar provave të marra në shqyrtim rezulton se janë respektuar gjatë kryerjes së kontrollit nga inspektorët e kontrollit të DRT Shkodër.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson, se në rastin konkret kontrolli tatimor ka qenë një “verifikim në vend” sipas pikës 80.3.c të Udhëzimit nr. 24/2008 verifikim, i cili kryhet pa njoftimin paraprak të personit të tatueshem, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e ditës të lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend. Pala paditëse nuk ka paraqitur prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të palës së paditur sipas të cilit punonjësi nuk ishte deklaruar me datë _____ sipas detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008.

Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se akti i konstatimit të kundërvajtjes administrative është mbajtur në përputhje me nenet 13 dhe 14 të ligjit për kundërvajtjet nr.10

279/2010 duke qenë, se është mbajtur nga personat e ngarkuar me ligj, në vendet ku është konstatuar shkelja, vend ne të cilin rezulton të këtë ushtruar veprimtarine ekonomike pala paditëse, akti përshkruan faktin konkret të konstatuar është nenshkuar nga përpiluesit dhe pasqyrojnë refuzimin e nënshkrimit të përfaqësuesit së palës paditëse të kontrolluar. Sipas verifikimeve të të dhënave të akt konstatimit me deklaratimet e shoqërise në formularin E-sig 027 te muajit gusht 2015 nuk rezulton, qe punonjesi i gjetur duke punuar prane pales paditese të jetë deklaruar të pakteë 24 orë para fillimit të punës. Lista për ndryshimet e fuqisë punëtore të palës paditese tregon, se deklarimi i punonjësit _____ të jetë bërë në organet tatimore jo me datë _____ siç kërkon ligji, por me datë _____ pas kryerjes së kontrollit nga pala e paditur.

Pretendimi i palës paditëse, se faqja e internetit e administrates tatimore nuk ka qenë e vlefshme për të mundësuar deklarimin elektronik të detyrimeve tatimore nuk është i mbështetur në prova. Ky fakt konfirmohet nga shkresa nr. _____ prot datë 13.08.2015 nga fakti, se kërkesa e palës paditëse për dorëzimin e listepagesës për shtimin e punonjesit është depozituar në DRT-ve Shkoder me datë _____ dhe pala paditëse nuk dokumenton dorëzimin me postë të kësaj deklarate të paktën një ditë para konstatimit me datë _____.

Sa më siper pretendimet e palës paditëse se ajo nuk e kishte kryer kundervajtjen, pasi jo për fajin e saj nuk kishte përmbushur detyrimin e nenit 119 të ligjit nr.9920/2008, të ndryshuar për deklarimin e punonjësit të paktën një ditë para ditës së fillimit të punës janë pretendime të pambështetura në prova dhe për pasojë vendimi objekt ankimi për këtë pjese duhet të lihet në fuqi.

Në lidhje me pretendimet për dënimin për shkelje të nenit 122/1/b të ligjit nr. 9920/2008 Gjykata Administrative e Apelit vlerëson, se këto pretendime të ankueses janë të pambështetura në prova dhe në ligj. Fakti i moslëshimit të kuponit apo dëftesës tatimore është konstatuar në aktin e konstatimit Nr. _____ datë _____ dhe pala paditëse pavarësisht faktit, se pretendon se nuk ka lëshuar kupon për mungesë objektive të përdorimit të kasës fiskale, ai nuk justifikon fajin e organeve tatimore në mos pajisjen e tij me dëftese tatimore me datë _____ sipas VKM-ve me nr.781/2007, 1476/2008, 1286/2009. Nga provat e marra në shqyrtim rezulton, se pala paditese ka raportuar defektin në pajisjen fiskale pranë autoriteteve tatimore me shkresën nr. _____, datë _____, shoqëruar me procesverbalin e mbajtur me shoqërine mirëmbajtëse të datës _____ dhe ka kërkuar për herë të parë nga organet tatimore pajisjen me dëftesë tatimore me datë _____, shumë kohë pas datës së aktit të konstatimit _____. Këto fakte tregojnë, se pala paditëse për faj të saj nuk ka kërkuar në kohë nga organet tatimore pajisjen me dëftesë tatimore në prani të defektit të pajisjes fiskale e për pasojë edhe për këtë pjesë me vendimin objekt ankimi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e padisë.

Në lidhje me pretendimet e paraqitura në ankim mbi gjobën prej 20 000 lekë për mos afishim të posterit për tërheqjen e kuponit tatimor të vendosur në bazë të nenit 122 /1/d) të ligjit 9920/2008 Gjykata Administrative e Apelit vlerëson, se me të drejtë me vendimin objekt ankimi është proceduar me rrëzimin e këtij pretendimi, pasi pala paditëse nuk ka provuar se e kishte përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin 46 te ligjit nr.9920/2008. Ky pretendim nuk është paraqitur në momentin e mbajtjes së akt-konstatimit Nr. _____ datë _____ dhe as nuk është dokumentuar me prova nga pala paditëse, e cila në këtë rast duke qene se organi tatimor mohon kryerjen e një veprimi nga

tatimpaguesi, ky i fundit ka barrën e provës për të provuar të kundërtën.

Gjykata Administrative e Apelit vlereson, se shkaqet e paraqitura ne ankim nuk qëndrojnë dhe se vendimi Nr.1235 datë 15.03.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane duhet të lihet në fuqi si një vendim i drejtë i bazuar në prova e në ligj.

Vendim:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. ____ datë ____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*
- *Kundër vendimit nuk lejohet rekurs*

4. Vendim nr. 376, datë 10.06.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Person Fizik K.S

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti:

1. Shfuqizimin tërësisht të aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot, datë ____ të DRT Sarandë.
2. Shfuqizimin tërësisht të aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr. ____ datë ____ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë në vlerën 2.535.161 leke, lënë në fuqi me vendimin nr. ____ datë ____ të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.
3. Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrative vendimi i Drejtorisë së Apelimit Tatimor pranë M.F nr. ____ prot., datë ____ për pjesën e pashfuqizuar në shumën 1.410.144 lekë

Shuma e detyrimit tatimore:

Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot, datë ____ i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë për gjobën në vlerën 50,000 lekë dhe Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot datë ____ i DRT Sarandë në vlerën 1.342.144 lekë.

Baza Ligjore:

1. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
2. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Kodi i Procedurave Civile.

Përmbledhje e fakteve:

Tatimpaguesi “K.S”, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me kërkesëpadinë me objekt:

Shfuqizimin tërësisht të aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot datë ____ të DRT Sarandë në vlerën 50.000 lekë.

Shfuqizimin tërësisht të aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr. ____ datë ____ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë në vlerën 2.535.161 leke, lënë në fuqi me vendimin nr. ____ datë ____ të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrative vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë M.F nr. ____ prot datë ____ për pjesën e pashfuqizuar në shumën 1.410.144 lekë

Këto akte administrativë Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore janë nxjerrë nga DRT Sarandë bazuar në aktin e konstatimit nr.serie ____ datë ____, ku pas një verifikimi në vend të kryer nga inspektorët e Sektorit Task-Forcë në DHT Rajoni Qëndror, është konstatuar se ky tatimpagues nuk ka lëshuar kupon tatimor për 32 dhoma hoteli.

Referuar kësaj shkeljeje administrative të kryer, nga grupi i kontrollit u mbajt procesverbali i gjobës nr. ____ datë ____ nëpërmjet të cilit tatimpaguesi “K.S”, u penalizua me gjobë në shumën 50,000 lekë, për moslëshim kuponi tatimor, në zbatim të nenit 122 pika 1 gërma b (i) të Ligjit nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Në vijim nga ana e DRT Sarandë në referim të nenit 122 pika 1 gërma b(i) të Ligjit 9920/2008, i ndryshuar, ka vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore duke kryer vlerësimin tatimor të këtij subjekti për tre muajt e fundit. Aakti i rivlerësimit është nxjerrë me nr. ____ prot datë ____ për tatimpaguesin “K” duke i nxjerrë një detyrim në total në shumën 2.535.161 lekë.

Më pas nga DRT Sarandë janë nxjerrë dhe aktet administrativë përkatës e konkretisht Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot., datë ____ për shumën 50.000 leke, moslëshim kuponi tatimor dhe Njoftim Vlerësimi nr. ____ prot., datë ____ në vlerën 2.535.161 lekë.

Tatimpaguesi “K.S”, ka ankimuar në DAT Tiranë aktet administrativë të nxjerrë nga DRT Sarandë e konkretisht Njoftim Vlerësimin nr. ____, datë ____ dhe Njoftim Vlerësimin nr. ____, datë ____ . DAT Tiranë pasi ka marrë në shqyrtim këtë ankim me vendimin e saj nr. ____ prot, datë ____, ka vendosur: *Lënie në fuqi të aktit administrative, Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot datë 23.11.2017, nxjerrë nga DRT Sarandë për gjobën në shumën 50.000 lekë.*

Shfuqizimin e aktit administrative Njoftim Vlerësimi nr. ____ datë ____ për gjobën në shumën 1.193.017 lekë.

Lënie në fuqi të aktit administrative Njoftim Vlerësimi nr. ____, datë ____ për detyrimet në shumën 1.342.144 lekë.

Më pas ky tatimpagues ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor, ndaj këtyre akteve administrative, duke kërkuar shfuqizimin e akteve administrativë Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot datë ____, Njoftim Vlerësimi nr. ____ prot datë ____ dhe Vendimit nr. ____ prot datë ____ të DAT-së.

Kjo çështje pasi u gjykua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me vendimin e saj nr.190 datë 04.04.2018 ka vendosur: *Pranimin pjesërisht të padisë.*

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykatë ka vlerësuar se ankimi i palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë përmban shkaqe ligjore që motivojnë cënimin e vendimit nr.190 datë 04.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë si vendim i dhënë në zbatim të gabuar të ligjit. Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur janë të bazuara në ligj e në prova.

Gjykata Administrative e Apelit në analizë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, të ankimit, të provave dhe fakteve objekt gjykimi, bën një vlerësim të ri të provave të ndryshme nga ai i bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe arrin në konkluzione të ndryshme duke vlerësuar se kërkimet e palës paditëse nuk gjenden të mbështetura në prova dhe në ligj, e në këto kushte arrin në përfundimin se vendimarrja e dhënë nga gjykata e shkallës së parë është jo e drejtë dhe në keqbesim të ligjit material dhe si e tillë duhet ndryshuar dhe vendosur rrëzimi i padisë.

Rezulton e provuar se ndaj palës paditëse “K.S”, është ushtruar kontroll nga inspektorët e zbatimit në sektorin task-forcë në DHT Rajoni Qëndror. Gjatë kontrollit në vend rezultoi se subjekti gjatë veprimeve të tij tregtare nuk priste kupon tatimor për të gjithë klientët. Nga inspektorët që kanë kryer verifikimin në vend është mbajtur dhe procesverbal gjobe duke penalizuar këtë subjekt me gjobë në shumën 50.000 lekë në zbatim të nenit 122 pika 1 gërma b(i) të Ligjit 9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.Sh”, i ndryshuar.

Kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit e vlerëson të drejtë qëndrimin e mbajtur nga pala e paditur DRT Sarandë. Në analizë të dosjes objekt shqyrtimi gjyqësor rezultoi se Njoftim Vlerësimi i nxjerrë nga DRT Sarandë është bazuar në aktet e konstatimit të inspektorëve të palës së paditur, të cilat shërbejnë si bazë për marrjen e vendimit për kundravajtjet administrative në fushën e tatimeve.

Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se aktet e konstatimit të fakteve që kanë shërbyer si shkak për të proçeduar me dënimet administrative sipa ligjit 9920/2008, janë mbajtur në përputhje me nenin 13/b e 14 të Ligjit 10129/2010 ‘Për Kundravajtjet administrative’, nenet 71,72 e 80 të Ligjit 9920/2008 , Udhëzuesin nr.22225 datë 16.07.2015 dhe Udhëzuesin nr.22774 datë 03.10.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Ndryshe nga sa ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se në rastin konkret DRT Sarandë ka provuar se ka ndjekur proçedurat tatimore të përcaktuara në ligj dhe inspektorët e palës së paditur kanë dokumentuar në vend shkeljen tatimore të pretenduar të kryer prej paditësit si subjekt tatimor.

Po ashtu dhe proçedura e kryer nga DRT Sarandë për kryerjen e vlerësimit alternativ të palës pasditëse është kryer në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore dhe nuk ka asnjë element të pavlefshmërisë në

nxjerrjen e Njoftim Vlerësimit nr. ____ prot., datë ____, sipas asaj që është lënë në fuqi me vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. ____ prot., datë ____.

Gjykata e Apelit Administrativ, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara dhe provave të administruara në këtë gjykim, vlerëson se pala e paditur DRT Sarandë nga ana e saj provoi gjatë gjykimit me prova shkresore se subjekti paditës është gjetur në shkelje të ligjit nr.9920/20008 “Për procedurat Tatimore në R.SH”, i ndryshuar. Gjykata referuar provave në dosje si dhe dispozitave ligjore, vlerëson ndryshe provat nga sa janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, në të tilla rrethana kjo gjykatë vlerëson se shkelja konsiderohet e kryer dhe vlerëson se masa e gjobës e vendosur është e përcaktuar nga ligji, i përgjigjet ligjshmërisë së vlerësimit të palës së paditur që është dhe tagër i saj.

Vendimi i Gjykatës:

1. Ndryshimin e vendimit nr.190 datë 04.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
2. Rrëzimin e kërkesë padisë.

5. Vendim nr.00-2020-74, datë 08.06.2020

Gjykata e Lartë Tiranë

Paditës: Shoqëria “E.S” sh.p.k

I paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër

Drejtoria e Apelit Tatimor

Objekti:

1. Shfuqizimi i aktit njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot, datë ____ i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër
2. Shfuqizim i vendimit nr. ____ prot, datë ____ i Drejtorisë së Apelit Tatimor”

Shuma e detyrimit tatimor: 1 000 000 lekë

Baza ligjore:

Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 127, pika 1 “*Pengimi i kontrollit tatimor*”

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër kishte filluar gjykimi i çështjes gjyqësore me palë paditëse Shoqëria “E.S” sh.p.k, palë e paditur Drejtoria e Apelit Tatimor dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, me objekt gjykimi “kërkohet shfuqizimi i aktit njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ prot., datë ____ i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe shfuqizim i vendimit nr.____prot datë ____i Drejtorisë së Apelit Tatimor”.

Me njoftim-vlerësimin nr.____ prot datë ____ Shoqëria “E.S” sh.p.k është njoftuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër me detyrime, gjobë në vlerën 1 000 000 lekë dënim bazuar në nenin 127 pika 1 “*Pengimi i kontrollit tatimor*” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Shoqëria duke mos qenë dakort me këtë vlerësim të organit tatimor i është drejtuar me një kërkesë për apelim, Drejtorisë së Apelit Tatimor si organi i shqyrtimit të çështjes në rrugë administrative.

Drejtorja e Apelit Tatimor është përgjigjur me vendimin e saj nr.____prot datë____, nëpërmjet të cilit vendosi: *Refuzimin e ankimit, pasi mungon njoftim vlerësimi i ankimuar*

Referuar vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr.____prot, datë ____kjo Drejtori shprehet se, nga shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore të subjektit është konstatuar mungesa e dokumentacionit të përcaktuar në Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH-së, i ndryshuar, pika 106.2.4.

Bazuar në nenin 106 piken 2 dhe 5 me shkresën nr. ____prot, datë ____ Drejtoria e Apelit Tatimor ka kërkuar nga tatimpaguesi kopje të njoftim vlerësimit tatimor të ankimuar të plotësuar me të gjithë elementët që duhet të përmbajë një akt administrativ në përputhje me nenin 99 të Kodit të Procedurave Administrative dhe paragrafin 70.1 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH-së”, i ndryshuar, çdo dokument tjetër që ka lidhje me çështjen.

Nga ana e tatimpaguesit me shkresë të protokolluar në Drejtorinë e Apelit Tatimor me nr. ____ datë ____ janë dërguar sqarime për ankimin duke bashkëlidhur dokumentët që citohen në aktin, vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor, por rezulton se nuk ka dërguar njoftim vlerësimit tatimor nr.____ prot datë ____, të cilin në fakt e citon në shkresën e tij me lëndë “*Kundërshtim i njoftim vlerësimit tatimor nr.____ prot., datë ____*”, për të cilin ankimonte dhe që i ishte kërkuar nga D.A.T-or me shkresën nr.____ prot, datë ____.

Duke qenë se, kërkesa ankimore e subjektit nuk plotësonte kushtet e përcaktuara në paragrafin 106.2.4 të Udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH-së, i ndryshuar, Drejtoria e Apelit Tatimor ka refuzuar ankimin e tatimpaguesit.

Vlerësimi i Gjykatës së Lartë:

Kolegji vlerëson të nevojshme që paraprakisht të sjellë në vëmendje parashikimin e posaçëm ligjor të nenit 9 të Ligjit nr.49/2012 dispozitë, e cila rregullon çështjen e vendimmarrjes së gjykatës dhe kontestit ligjor të palëve mbi disponimet gjyqësore për juridiksionin. Kjo dispozite parashikon se: “*I.Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit qoftë edhe kryesisht kur konstaton se çështja nuk bën*

pjesë në juridiksionin gjyqësor merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent.

2. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji vendos në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve, nëse çështja përfshihet ose jo në juridiksionin gjyqësor. Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin.

3. Kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton, se çështja është brenda juridiksionit gjyqësor prish vendimin dhe e dërgon çështjen për vazhdimin e gjykimit me të njëjtin trup gjykues në gjykatën që kishte vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit.

Kjo normë e Ligjit nr.49/2012 rregullon ndryshe çështjen e ankimit të veçantë të vendimit të ndërmjetëm të gjykatës administrative që vendos rrëzimin e prapësimit apo kërkesës së një pale për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, në raport me rregullimin e nenit 59 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet se : “Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit qoftë edhe kryesisht merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë”.

Kështu dallohet se në procesin civil ndaj dy llojeve të vendimeve dhe disponimeve gjyqësore mbi juridiksionin lejohet ankim i veçantë. Ndërkohë në nenin 9 të ligjit nr.49/2012 ankimi i veçantë lejohet vetëm ndaj vendimit jopërfundimtar të gjykatës, që nxjerr çështjen jashtë juridiksionit. Duke mos lejuar ligji ankim të veçantë, konkretisht rekurs të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që rrëzon prapësimin apo kërkesën e një pale për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor do të thotë, se në këto raste ndaj këtyre vendimeve do të zbatohet rregullimi i përgjithshëm dhe i zakonshëm ligjor për ankimin e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës. Pra ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës administrative, që rrëzon prapësimin apo kërkesën e palës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor nuk mund të ushtrohet ankim i veçantë, por do të ushtrohet ankim i zakonshëm, domethënë apel apo rekurs bashkë me vendimin përfundimtar apo jopërfundimtar.

Kolegji mban parasysh në këtë analizë edhe faktin, se praktika e mëparshme e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka konkluduar ndryshe mbi këtë çështje.

Kolegji Administrativ në këtë praktikë gjyqësore ka konkluduar se neni 9 i Ligjit nr.49/2012, pavarësisht, se ometon në ofrimin e një rekursi të drejtpërdrejtë për vendimin e ndërmjetëm të gjykatës që nuk pranon të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit do të duhet të komplementohet nga parashikimi i paragrafit të dytë të nenit 59 të Kodit të Procedurës Civile.

Kolegji mban parasysh, se në bazë dhe për zbatim të nenit 1 pika 2 të Ligjit nr.49/2012 rregullimet e posaçme ligjore të ligjit për gjykimin administrativ do të prevalojnë ndaj rregullimeve të përgjithshme ligjore të Kodit të Procedurës Civile. Këto të fundit do të zbatohen vetëm atëherë kur ligji për

gjykimin administrativ ka ometuar në rregullimet e tij apo i vetëreferohet për zgjidhje ligjore parashikimeve të përgjithshme procedurale.

Kolegji konkludon se praktika gjyqësore e mëparshme duke lejuar ankim të veçantë ndaj vendimeve të ndërmjetme të gjykatës administrative, që disponojnë mbi rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit ka lene pa fuqi rregullimin e posaçëm ligjor, konkretisht nenin 9 të Ligjit nr.49/2012, i cili sipas pikës 2 të nenit 1 të këtij ligji është i detyrueshem për t'u zbatuar në këto raste. Kolegji konkludon, se rregullimi i posaçëm i nenit 9 të Ligjit nr. 49/2012 mbi këtë çështje ligjore përjashton mundësinë e zbatimit të paragrafit të dytë të nenit 59 të Kodit të Procedures Civile.

Kolegji sjell në vëmendje se ndryshimi i rregullimit ligjor ndërmjet nenit 9 të Ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 59 të Kodit të Procedures Civile është vullnet i qëllimshëm i ligjvënësit, me synimin që të adresojë zgjidhje efektive dhe të shpejta ligjore për zhvillimin e gjykimit administrativ brenda afateve kohore sa më të arsyeshme. Në këtë mënyrë Kolegji vlereson se qëllimi i ligjvënësit ka qene i qartë kur ka parashikuar ankimin e veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe jo për të kundërtën. Kështu, Kolegji konkludon, se ka nevojë të menjëhershme për kontrollin gjyqësor nga Gjykata e Lartë në rastin e vendimeve jopërfundimtare të gjykatave administrative, me të cilat disponohet nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi kjo vendimmarrje gjyqësore potencialisht mund të shkaktojë cenimin në thelb të aksesit në drejtësi dhe për rrjedhojë edhe mohimin flagrant të mbrojtjes gjyqësore për individin. Ndërkohë ndryshe paraqitet çështja e vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që e mban çështjen në juridiksionin gjyqësor. Në keto raste nuk ka cenim dhe mohim flagrant apo në thelb të së drejtës së individit për akses në drejtësi, pasi pretendimet për mungesën e juridiksionit gjyqësor të palëve ndërgjyqëse do të shqyrtohen serish, nëpërmjet mjeteve të ankimit të zakonshëm në gjykatën më të lartë dhe sipas rregullave të përgjithshme.

Kolegji konkludon, se në gjykimin administrativ në bazë dhe për zbatim të nenit 9 të Ligjit nr.49/2012 lejohet ankim i veçantë vetëm ndaj vendimeve jopërfundimtare të gjykatës me të cilët çështja nxirret nga juridiksioni gjyqësor duke u pushuar gjykimi i padisë. Nga ana tjetër ndaj vendimeve të ndërmjetme të gjykatës me të cilat rrëzohet prapësimi apo kërkesa e një pale për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, lejohet ankim apo rekurs sipas rregullave të zakonshme, që do të thotë bashkë me vendimin përfundimtar apo jopërfundimtar.

Përderisa në vijimsi do të mbahet ky qëndrim i arsyetuar Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë sjell në vëmendjen e gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të palëve në process, se ankimet e veçanta për rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor nuk duhet të pranohen dhe për rrjedhojë nuk duhet të lejohen të vijnë me këtë mekanizëm rekursi të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë.

Vendimi i gjykatës:

- *Mospranimi i ankimit të veçantë të palës së paditur*

Pas gjykimit në thelb të çështjes vendosi:

- *Rrëzimin e padisë.*

6. Vendim nr.620, datë 22.06.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Subjekti “D.L”

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Objekti:

1. Anullim i aktit administrative Njoftim Vlerësimi nr.____ prot datë ____i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë.

2. Anullimi i vendimit nr. _____ prot., datë ____ i Drejtorisë së Apeliti Tatimor Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimore: 507,000 lekë.

Baza Ligjore:

1. Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”
2. Neni 17 (1.a), 32, 153,154 i K.Pr.Civile,
3. Ligji 49/2012“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
4. Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Proçedurave administrative.”

Përmbledhje e fakteve:

Subjekti “D.L” sh.p.k i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me kërkesëpadinë me objekt: Anullim i aktit administrative Njoftim Vlerësimi nr.____ prot datë ____i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë. Anullimi i vendimit nr.____ prot., datë ____ i Drejtorisë së Apeliti Tatimor Tiranë.

Ky njoftim vlerësimi është nxjerrë nga DRT Sarandë bazuar në aktin e rivlerësimit të datës ____të mbajtur nga inspektori në drejtorinë e Vlerësimit të të ardhurave dhe Kontabilitetit në DRT Sarandë, referuar të dhënave të nxjerra nga aktet e konstatimit të mbajtura pranë palës paditëse nr. serie _____ datë ____, si dhe nr.____ datë ____ nga inspektorët e verifikimit në terren, fluksit të madh të turistëve që kishte në muajin gusht 2014 si dhe bazuar në memon nr.____ datë ____ të drejtorit të DRT Sarandë. Sipas akt konstatimeve të sipërcituara, është kryer kontroll tek adresa ku ushtron aktivitetin ekonomik pala paditëse subjekti “D.L” dhe nga verifikimi ka rezultuar se : subjekti ka në total 36 dhoma të zëna, nga të cilat 25 me klientë * 4.500 lekë për dhomë, në pjesën e barit ka 9 tavolina me klientë me vbelreë mesatare 200 lekë. Në datën ____ sipas aktit të konstatimit ____, nga 36 dhoma që ka hoteli, 14 prej tyre ishin me kliente me vlere 4.000 leke për dhomë. Bar restoranti disponon 15 tavolina nga të cilat

4 me klientë me vlerë 300 lekë tavolina si dhe 33 shezllone me vlerë 300 lekë për një shezllon. Referuar të dhënave të akteve të konstatimit mesatarja ditore e shitjeve del në shumën 75.583 lekë*30 ditë = 2.267.500 lekë. Shitjet e deklaruara nga subjekti janë në shumën 1.000.000 lekë. Për diferencën 1.267.500 lekë, inspektori për muajin gusht ka kryer velrësimin tatimore duke nxjerrë detyrimin në shumën 253.500 lekë dhe një gjobë në shumën 253.500 lekë.

Pas rivlerësimit të kryer nga ama e DRT Sarandë është nxjerrë aktin administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot datë ____, për detyrimin në TVSH në shumën 253.500 lekë dhe gjobën në vlerën 253,500 lekë. Në total detyrimi në shumën 507.000 lekë.

Tatimpaguesi “D.L”, ka ankimuar në DAT Tiranë Njoftim Vlerësimin e nxjerrë nga DRT Sarandë, e cila pasi ka marrë në shqyrtim këtë ankim me vendimin e saj nr. ____ prot, datë ____, ka vendosur: *Lënien në fuqi të aktit administrative, Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot datë ____, nxjerrë nga DRT Sarandë.*

Më pas subjekti ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor, ndaj këtyre akteve administrative, duke kërkuar anulimin e akteve administrativë Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot datë ____ të nxjerrë nga DRT Sarandë dhe vendimit nr. ____ prot, datë ____ të DAT-së.

Kjo çështje është gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, e cila me vendimin e saj nr. 305 datë 03.06.2015 ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadisë.

Konstatimin e pavlefshmërisë të aktit administrative Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ datë ____ të DRT Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr. ____ prot., datë ____ të Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tiranë.

Pas ankimit të paraqitur nga DRT Sarandë, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vendosi:

Prishjen e vendimit nr. 305 datë 03.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe kthimin e çështjes për rigjykim, në të njëjtën gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Kjo çështje pasi u rigjykua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me vendimin e saj nr.417 datë 16.07.2018 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë.

Shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ datë ____ të DRT Sarandë, lënë në fuqi me vendimin nr. ____ prot., datë ____ të Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tiranë. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të arsyetuar të vendimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim DRT Sarandë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë mori në shqyrtim në dhomë këshillimi këtë çështje administrative me vendimin e saj nr. 620 datë 22.06.2020 ka vlerësuar se:

Vlerësimi i Gjykatës:

Në analizë të shkaqeve të ngritura në ankim, gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi nr.417 datë 16.07.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë është rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor, marrë në zbatim të ligjit proçedural, që ka bërë një cilësim të drejtë dhe ligjor të mosmarrëveshjes në gjykim në raport me faktet dhe provat e marra në gjykim e për rrjedhojë duhet të lihet në fuqi.

Referuar provave në gjykim, rezulton se pala e paditur DRT Sarandë ka përdorur metoda alternative nga zyra, për nxjerrjen e vlerësimit të detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Në aktin e vlerësimit të mbajtur përcaktohet se ky rivlerësim është bazuar në dy aktet e konstatimit të datës ____ dhe _____. Për diferencën e konstatuar në shumën 1.267.500 lekë, inspektori për muajin gusht ka kryer vlerësim tatimor.

Barra e provës në gjykim të karakterit administrative është në ngarkim të organit publik, për të provuar si faket dhe provat e vëna në themel të vendimarrjes, të kontestuar në këtë gjykim.

Si ka arsyetuar në përputhje me ligjin gjykata administrative e shkallës së parë, administrata tatimore nuk ka provuar në këtë gjykim se:

Paditësi nuk ka dorëzuar deklaratën tatimore në përputhje me afatin dhe metodën e kërkuar nga legjislacioni. Pala e paditur nuk provoi se deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakata ose të fallsifikuara. Pala e paditur nuk provoi se seancë gjyqësore se paditësi nuk ruan llogari ose regjistrime të sakta të transaksioneve. Akt konstatimi i mbajtur nga pala paditëse nuk përmban shkelje të tilla që të çojnë në rivlerësim të detyrimit tatimor.

Pala e paditur nuk provoi se tatimpaguesi nuk ka bashkëpunuar me kontrollin tatimor.

Pala e paditur nuk provoi se tatimpaguesi nuk ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar dhe dokumente të tjera të nevojshme për llogaritjen e detyrimit të tij.

Pala e paditur nuk provoi se tatimpaguesi ka hyrë në transaksione me para në dorë që tejkalojnë shumën 300.000 lekë.

Pala e paditur nuk provoi se tatimpaguesi nuk ka përdorur rregullisht pajisjen fiskale.

Në keto kushte me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se inspektorët tatimore kanë bërë vlerësim në kundërshtim me nenin 71 të Ligjit 9920/2008. Vlera e detyrimit tatimor do të duhet të nxirrej duke marrë të dhëna të drejtëpërdrejta, dokumenta, informacion dhenë nga palët e treta etj... Ky detyrim buron nga neni 72 I Ligjit 9920/2008.

Në përfundim Gjykata Administrative e Apelit bazuar në neni 52 të ligjit 49/2012, vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë është i bazuar në ligj dhe në prova e për pasojë duhet të lihet në fuqi.

Vendimi i Gjykatës:

1. Lënie në fuqi të vendimit nr.417 datë 16.07.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
2. Kundër vendimit nuk lejohet rekurs.

7. Vendim nr. 704, datë 02.07.2020

Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë

Paditës: Shoqëria “E.D”

Të paditur: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj

Objekti:

1. Shfuqizimin e pjesshëm të Njoftim Vlerësimit nr. ____ prot., datë ____ lëshuar nga DTM.
2. Shfuqizimin tërësisht të Vendimit nr.____, datë____ të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Shuma e Detyrimit tatimor 35,374,362 Lekë.

Baza Ligjore:

1. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
2. Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
3. Ligji nr.7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vleren e Shtuar“;

Rrethanat dhe Faktet:

Nga krahasimi i sasive të tollonave të shitura me ato të kthyer, rezulton se për artikullin superplus, janë kthyer 99,300 litra (261,520 – 162,220) më tepër se janë deklaruar të ardhura gjatë vitit ushtrimor. Shoqëria deklaron në të ardhura të vitit të gjithë vlerën e tollonave të shitura gjatë këtij viti, pavarësisht se kthimi i këtyre tollonave brenda vitit ushtrimor mund të jetë më i vogël ose më i madh se ai i tollonave të shitura.

Kur kthimi i tyre është më i madh se ai i shitur, ky rast ka të bëjë me kthime tollonash që janë shpërndarë (shitur) në periudha para vitit ushtrimor dhe të pamaturuara para këtij viti ushtrimor. Kur kthimi i tollonave është më i vogël se ai i tollonave të shitura brenda vitit ushtrimor, shoqëria, të ardhurat nga shitja edhe të tollonave të pakthyer brenda vitit ushtrimor, i deklaron në të ardhura të tatueshme dhe jo në “Të ardhura në avancë” në përputhje me kërkesat e SNK 18 “Te ardhurat” pika 19: *“... të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me të njëjtin transaksion ose ngjarje tjetër njihen njëkohësisht; zakonisht ky proces quhet përqasja e të ardhurave me shpenzimet. Zakonisht shpenzimet, përfshijnë garancitë dhe kostot e tjera që priten të ndodhin pas lëvrimit të mallrave dhe produkteve, mund të maten në mënyrë të besueshme kur plotësohen kushtet e tjera për njohjen e të ardhurave. Megjithatë, të ardhurat nuk mund të njihen nëse shpenzimet nuk mund të maten në mënyrë*

të besueshme; në rrethana të tilla, çdo shumë e konsideruar tashmë e marrë për shitjen e mallrave dhe produkteve do të njihet si detyrim”

Në zbatim të kërkesave të ligjit Nr.8438, dt.28.12.2003 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, neni 20 e Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006, i ndryshuar, pika 3.5, shpenzimet për tollonat e kthyer më tepër se ato të shitura brenda periudhës tatimore, nuk kanë realizuar të ardhura që i takojnë kësaj periudhë tatimore. Pra shpenzimet e kthimit të këtyre tollonave, nuk përbëjnë shpenzime të njohura ushtrimore. Shoqëria SHA, në bazë të ligjit “Për Hidrokarburet” është e detyruar të shesë karburant vetëm me shumicë dhe vetëm për shoqëritë Shpk të karburantëve. Shoqëria SHA (pala paditëse) përveç shitjes së karburantit lëng kryen edhe shërbimin e shitjes dhe blerjes së tollona. Tollonat shiten kryesisht për institucionet shtetërore me tender dhe me kontratë si dhe për shoqëri të tjera private po me kontratë. Po këto tollona shoqëria SHA i blen nga shoqëritë Shpk që kanë pranuar dhe konvertuar në lëng këto tollona nga poseduesit e tyre.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 704 dt.02.07.2020 ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ku ka pranuar pjesërisht kërkesë padinë e shoqërisë “ E.D” duke arsyetuar si më poshtë vijon:

Shoqëria SHA,”E.D” në bazë të ligjit “Për Hidrokarburet” është e detyruar të shesë karburant vetëm me shumicë dhe vetëm për shoqëritë Shpk të karburanteve. Shoqëria SHA përveç shitjes së karburantit lëng kryen edhe shërbimin e shitjes dhe blerjes së tollona. Tollonat shiten kryesisht për institucionet shtetërore me tender dhe me kontratë si dhe për shoqëri të tjera private po me kontratë. Po këto tollona shoqëria SHA i blen nga shoqëritë shpk që kanë pranuar dhe konvertuar në lëng këto tollona nga poseduesit e tyre.

Procedurat e shitjes së tollonave nga shoqëria SHA për institucionet dhe blerësit e tjere privat dhe procedurat e shitjes së këtyre tollonave nga shoqëritë shpk të karburanteve për shoqërinë SHA kryhet në zbatim të kreut të parë të UMF nr. 17, datë 13.5.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, (i ndryshuar), kreu 9.4. **“Furnizimi i karburanteve”**, germa **“d”**, ku thuhet:

“Kur karburanti furnizohet me tollona, në momentin e dorëzimit të tollonave, apo nëse më parë është bërë ndonjë pagesë, shoqëria furnizuese lëshon faturë tatimore për përfituesin e tollonave dhe lëshimi faturës, përbën momentin e furnizimit.

Vlera e tatueshme e furnizimit përcaktohet nga çmimi i paraqitur i faturës së lëshuar nga shoqëria furnizuese”.

Në çdo rast fatura e shitjes dhe blerjes shoqërohet edhe me tollonat përkatës që vërtetojnë sasinë në litra që permban kjo faturë. Çmimi i shitjes së karburantit me tollon për vitin 2014, nuk mund të rivlerësohet, pasi shitja e karburantit me tollona ka një specifikë sipas se ciles çmimi shitjes nuk përputhet në kohë me çmimin e kthimit të tollonit. Trendi i çmimit të karburantit mund të pësojë ngritje apo ulje, gjë që kryesisht varet nga bursa, por edhe nga kërkesë oferta fenomen që një vit të

caktuar mund ta nxjerrë shoqërine ose me fitim ose me humbje. Pala paditëse ka tregtuar mall sipas çmimeve të tregut dhe politikës së saj të çmimeve. Brenda normave të një ekonomie konkurrenciale. Si pasojë e shitjes së tollonave ne nje kohe dhe kthimit të tyre në një kohë të mëpasshme dhe luhatjes së çmimit pala paditëse ka rezultuar me humbje në shitjen e karburantit me tollona.

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se rivlerësimi i bërë nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për të ardhurat e shoqërisë është i pabazuar në ligj. Për rrjedhojë detyrimi i TVSH-së dhe TF uljes së humbjes me vlerë 32,111,115 lekë të vitit 2014 duhet shfuqizuar duke pranuar kërkesë padinë.

Vendimi i gjykatës:

Pranimin e kërkesë padisë.

8. Vendim nr.761, datë 27.07.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Padites: Shoqëria “N”

I paditur: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj
2. Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti:

1. Anullim i njoftim vlerësimit nr.____, datë 02.08.2011 dhe 1489/13, datë 23.11.2011 të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.
2. Anullimin e vendimit nr. __, datë __ të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Shuma e detyrimit tatimor: 1.513.967 lekë

Baza Ligjore:

1. Kodi i Procedurave Administrative
2. Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
3. Ligji nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”
4. Ligji nr.8438/1998 “Per Tatimin mbi të Ardhurat”

Përmbledhje e Fakteve:

Shoqërisë “N” sh.a, i janë llogaritur detyrime (tatim në burim) dhe penalitete në shumën totale 1.513.967 lekë.

Këto detyrime janë nxjerrë me njoftim vlerësimit nr.____, datë ____ dhe nr.____, datë ____.

Llogaritja e detyrimit për tatimin në burim është bërë për shërbime të mirmbajtjes teknike të dhëna online dhe jo në Shqipëri, për mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit informatik të shoqërisë. Këto shërbime janë ofruar nga subjekti jorezident “Opportunity International”, e cila është e vendosur në USA.

Në bazë të gërmës “d” të nenit 33, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, dhe gërmës “e” të pikës 5.2 të Udhëzimit Ministrisë Financave nr.5, datë 30.01.2006 në zbatim të ligjit dhe interpretimit të bërë nga DPT, nuk do të mbahet tatim në burim për personat jorezidentë, në lidhje me shërbime që ata kryejnë në kuadrin e veprimtarisë së tyre biznesore për persona rezidentë shqiptarë, vetëm kur parashikohet në dispozitat e marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë që Shqipëria ka lidhur me vendin, rezident i së cilës është përfituesi i të ardhurave.

Nga verifikimet dhe pergjigja e DPT rezulton se ndermjet R.SH dhe USA nuk ka një marrëveshje tatimore për shmangien nga taksimi i dyfishtë. Sa më sipër palës paditese i lind detyrimi për të mbajtur tatim në burim për shërbimet e ofruara.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 761, datë 27.07.2020 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Mbështetur në prapesimet e pales se paditur, si dhe akt ekspertimit të mbajtur nga eksperti kontabël, gjykata ka arritur në përfundimin që për sa kohë nuk ka një marrëveshje 2 palëshe ndërmjet Republikën e Shqipërisë dhe SHBA për shmangien e tatimit të dyfishtë, referuar të drejtës sonë fiskale dhe ligjit nr.8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, pala paditëse ishte e detyruar të mbante tatim në masën 10% për shumën e paguar shoqërisë jo rezidente në Shqipëri.

Vendim:

1. Lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë nr. 5036, datë 17.05.2012.
2. Rrëzimin e kërkesë padisë së shoqërisë.

Pavlefshmëria Absolute

9. Vendim nr. 951, datë 18.11.2020

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “L” sh.p.k

I Paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë

Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë, pranë DPT Tiranë

Objekti: Konstatimi i pavlefshmërisë absolute si dhe shfuqizimi i akteve administrative Njoftim vlerësimi për detyrimin nr. ___, datë ___ të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë si dhe Vendimi i Drejtorisë së Apelimit Tatimor pranë DPT Tiranë, ardhur me shkresën nr. ___, datë ___

Shuma e detyrimit tatimor: 3,075,423 lekë

Bazaligjore:

1. Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar përaktësisht Neni 116, 108.5;
2. UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar;
3. Udhëzimin nr. 17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”;
4. Ligjit nr.7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, Neni 41;
5. Ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
6. Kodi i Procedurave Administrative.

Përmbledhje e Fakteve:

Në bazë të urdhrit të punës me 13768 prot, datë 12.11.2012, inspektorët e kontrollit pranë DRT Vlorë kanë ushtruar një kontroll në ambjentet e subjektit “L” sh.p.k. Nga kontrolli i ushtruar është mbajtur Akt-Konstatimit me nr. serial ___, datë ___ ku është cituar se: *“në pamundësi të tërheqjes së dokumentacionit të nevojshëm për ushtrimin e kontrollit i është lënë si detyrë shoqërisë “L” sh.p.k, të paraqesë dokumentacionin pranë DRT Vlorë në datë 19.11.2012”*. Dokumentacioni i kërkuar është vënë në dispozicion të kontrollit brenda afatit të përcaktuar në Akt – Konstatim dhe është mbajtur akti i konstatimi i datës 02.11.2012 nga inxhinjeri ku rezulton se: *“Në momentin e kontrollit shoqëria nuk kishte deklaruar punime për dy zëra: 1. F.V. Beton pllaka e themelit 738m³*6.775 lekëm²=4.999.950 lekë; 2. F.V.Hekur pllaka e themelit 30 Ton*88.300 lekë/ ton=2.649.000 lekë”*. Shoqëria ka pretenduar se punimet e kryera dhe të pa deklaruara nga inspektimi i tatimorëve janë

punime të kryera në muajin Nëntor 2012 dhe të deklaruar në situacionin e këtij muaji. Në momentin e mbajtjes së Akt Konstatimit punimet ishin në proces dhe më pas janë deklaruar në situacionin dhe fdp e muajit Nëntor 2012 dhe nuk ka asnjë diferencë midis situacionit progresiv dhe Akt Konstatimit të kryer nga inspektorët tatimor.

Sa më sipër, nga inspektorët është vlerësuar se dy zërat e punimeve të pa deklaruar i përkasin një niveli fillestar të ndërtimit, dhe referuar situacionit progresiv vihet re se janë deklaruar zëra punimesh të cilat sipas procedurave të ndërtimit janë të mëvonëshme. Nuk janë deklaruar F.V.Beton pllaka e themelit dhe F.V.Hekur pllaka e themelit, të cilat janë në bazament të një ndërtimi por janë deklaruar “Punime armature, traret pilot & betoni” dhe “F.V hekuri për muret dhe kollona”, të cilat janë mbi themele dhe vazhdimi i ndërtimit në lartësi. Dokumentacioni që është paraqitur nga tatimpaguesi nuk konsiderohet provë e mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij, pasi ky dokumentacion është paraqitur pranë DAT Vlorë në një periudhë të mëvonëshme se sa konstatimi i mungesës së elementëve të përcaktuar në Udhëzimin nr. 17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”, çka nënkupton mundësin e plotësimit të këtyre mangësive në një moment të mëvonshëm se sa kryerja e kontrollit.

Mungesa e konstatuar është vlerësuar nga administrata tatimore si shitje pa lëshuar faturë tatimore. Moslëshimi i faturës tatimore për shitjet e kryera shmang në mënyrë të drejtpërdrejtë deklarimin dhe pagesën e detyrimit tatimor referuar TVSH-së në lidhje me furnizimin e kryer dhe të ardhurat e krijuara, por të padeklaruar. Moslëshimi i faturës tatimore, dënohet me gjobë në masën 100% të diferencës së shumës së tatimit të përlogaritur, nga ajo që duhet të ishte në fakt, referuar Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 116.

Mosdeklarimi i këtyre shitjeve ka sjell fshehje të detyrimeve tatimore, nëpërmjet dorëzimit të deklaratave të pavërteta dhe informacioneve jo reale, çka ka sjell përlogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, duke kryer në këtë mënyrë evazion tatimor, referuar kuptimit që i jepet këtij termi në Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, paragrafi 116.1, ku citojmë: *“në kuptim të këtij neni termi “evazion fiskal” përfshin... mosdeklarimin e shitjeve dhe të ardhurave të realizuara...”*

Referuar Ligjit nr.7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në” Neni 41, subjekti detyrohet të paguaj TVSH në masën 20%, në shumën 1.529.790 lekë dhe gjobë në masën 100% të detyrimit tatimor, në shumën 1.529.790 lekë, në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Pretendimet e shoqërisë se punimet ishin në proces dhe janë deklaruar në fund të muajit nuk vërtetohen prej saj nëpërmjet dokumentacionit përkatës kontabël dhe teknik të përcaktuar në legjislacionin tatimor, ndërkohë që në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 108.5, përcaktohet se: *“Barra e provës, për të vërtetuar se një vlerësim tatimor ose vendim është i pasaktë, bie mbi tatimpaguesin”.*

Për këto penalitete subjekti është njoftuar nëpërmjet Njoftim Vlerësimit nr. ____ prot, datë ____ i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata ka vlerësuar se, gjykata e shkallës së parë, ka gabuar në cilësimin e fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, për pasojë edhe ka keq interpretuar dispozitat ligjore e nënligjore në të cilat disiplinohet marrëdhënia ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve.

Gjykata e Shkallës së Parë, ka pranuar pretendimin e palës paditëse sipas të cilës punimet që pala e paditur i ka vlerësuar si të padeklaruara në FDP e muajit tetor kanë qenë punime në proces dhe janë deklaruar në FDP e muajit nëntor. Kështu, gjykata ka arritur në përfundimin se paditësi ka deklaruar rregullisht punimet e për rrjedhojë nuk ka diferenca shpenzimesh të padeklaruara për efekt të llogaritjes së TVSH mujore.

Pra, është e qartë për gjykatën se mosmarrëveshja ndërmjet palëve ka të bëjë me vërtetimin e fakteve dhe jo me mënyrën e zbatimit të ligjit. Sipas palës paditëse, pala e paditur ka gabuar në vërtetimin e faktit që ka të bëjë me fazën e kryerjes së punimeve për të cilat duhej të bëhej deklarimi në FDP e muajit tetor 2012.

Gjykata Administrative e Apelit cmon se me të drejtë pala e paditur pas kontrollit të ushtruar mbi dokumentacionin ligjor dhe teknik të palës paditëse ka konstatuar se, në momentin e kontrollit nga ana e palës paditëse nuk ishte deklaruar vlera prej 7.648.950 lekë, për punimet që ishin kryer deri në momentin e kontrollit. Pala e paditur pasi ka verifikuar programin e progresit të punimeve sipas preventivit dhe situacioneve të dorëzuara, ka konstatuar se pala paditëse ka kryer punime të cilat vijnë më herët në radhë sipas progresit të punimeve dhe nuk ka deklaruar shpenzimet për këto punime të kryera, duke fshehur në këtë mënyrë shpenzimet për të cilat duhet të paguhen detyrimet tatimore.

Gjykata Administrative e Apelit e ka vlerësuar të drejtë pretendimin e ngritur në ankim nga pala e paditur sipas të cilit, dy zërat e punimeve të padeklaruara i përkasin një niveli fillestar të ndërtimit, dhe referuar situacionit progresiv vihet re se janë deklaruar zëra punimesh të cilat sipas procedurave të ndërtimit janë të mëvonshme. Konkretisht, rezulton se nuk janë deklaruar punime të tilla si “F.V Beton pllaka themeli” dhe “F.V. Hekur pllaka themeli”, të cilat nga pikëpamja inxhinierike janë punime në bazament të një ndërtimi që do të thotë se janë ato që duhet të deklarohen në situacionet e para. Ndërkohë rezulton se janë deklaruar “Punime armature, trarë pilot dhe betoni” dhe F.V Hekuri për muret dhe kollona,” të cilat janë mbi themele dhe vijnë në rend kronologjik pas punimeve të tilla si “F.V. Beton pllaka e themelit” dhe “F.V. Hekur pllaka e themelit”.

Në këto rrethana, pala e paditur në ushtrim të funksioneve të veta administrative që konsistojnë në mbikëqyrjen dhe kontrollin e deklaratave tatimore të dorëzuara nga tatimpaguesit nëpërmjet mekanizmave të kontrollit sipas mënyrave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 24/2008, pasi ka konstatuar diferencën e padekluar nga pala paditëse në FDP e muajit tetor, ka kryer vetë sistemimin e deklaratës duke i njoftuar në përfundim paditësit detyrimin e TVSH-së që duhet të paguajë në favor të administratës tatimore. Përveç detyrimit tatimor, me të drejtë pala e paditur e ka konsideruar këtë fakt si fshehje të detyrimeve tatimore, duke e sanksionuar sipas Nenit 116 të Ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, me gjobë në masën sa 100% e vlerës së detyrimit.

Dokumentacioni që është paraqitur nga tatimpaguesi me të drejtë nuk është konsideruar si provë e mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij, pasi ky dokumentacion është paraqitur pranë DAT Tiranë në një periudhë të mëvonshme se sa konstatimi i mungesës së elementëve të përcaktuar në

Udhëzimin nr. 17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”, cka nënkupton mundësinë e plotësimit të këtyre mangësive në një moment të mëvonshëm se sa kryerja e kontrollit.

Në këtë mënyrë akti administrativ Njoftim Vlerësimi nr. ___, datë ___ i DRT Vlorë si dhe vendimi nr. ___, datë ___ i Drejtorisë së Apelit Tatimor janë akte të vlefshme nga pikëpamja juridike.

Vendim:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 507, datë 11.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Rrëzimin e Padisë.